



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, neneve 11 par.1.2 dhe 13 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme Nr.03/L-204 Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.88 e datës 25 nëntor 2010, Udhëzimit nr.04/2011 për përcaktimin e vlerës së pronës së paluajtshme dhe standardet e vlerësimit si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR PËRCAKTIMIN E VLERËS SË PRONËS SË PALUAJTSHME TË
KOMUNËS SË LIPJANIT

Neni 1
Përbërja

Formohet Komisioni për përcaktimin e vlerës së pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit, e cila do të shërbej për caktimin e bazës tatimore në pronën e paluajtshme për vitin 2018, në përbërje si vijon:

1. Shemsi Azemi, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, Kryesues
2. Shaban Sylja, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtar
3. Ilir Shala, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, anëtar

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Detyrë e Komisionit është që duke u bazuar në dispozitat e neneve 11 par.1.2 dhe 13 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme si dhe të dispozitave të Udhëzimit nr.04/2011 për përcaktimin e vlerës së pronës së paluajtshme dhe standardet e vlerësimit, të bëjë vlerësimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit për tu aplikuar sipas Rregullores të Kuvendit të Komunës në vitin 2018, sipas kategorive të pronës dhe vendodhjes së pronës.

Gjatë hartimit të vlerësimit Komisioni do të bashkëpunoj me Drejtoratin për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoratin për Gjeodezi dhe Kadastër.

Pas analizave të vlerësimit në pajtim të dispozitave të kartëcekura, Komisioni do të hartoj modelin e vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës, të cilin do t'ia dërgoj Drejtoratit për Buxhet dhe Financa dhe një kopje për Kryetarin e Komunës më së largu deri më 15.08.2017.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin të njoftohen Ministria e Financave - Departamenti i Tatimit në Pronë, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 432 - 31919
Lipjan, më 19.07.2017

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

